

Në bazë të nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, nenit 12 alinea 1 dhe 2 dhe të nenit 17 alinea 1, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 27 alinea 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2009, miratoi këtë:

**V E N D I M**  
**PËR LEJIMIN E LËSHIMIT TË LEJES SË NDËRTIMIT KOMPANISË "Zinkunie"**

Neni 1

Me këtë Vendim lejohej lëshimi i Lejes së ndërtimit, për ndërtimin e objekteve të përkohshëm, nga ana e kompanisë "Zinkunie" si rast i veçantë, bazuar në kërkesën për lejimin e zhvillimit të Parkut Industrial Holandez të dt.10.07.2009 nr.01023 /457, jashtë kushteve të përcaktuara me Vendimin për caktimin e kushteve të përkohshme rreth ndërtimit të përkohshëm të objekteve në territorin e komunës së Prizrenit, nr.01/011-46, të datës 20 tetor 2005.

Neni 2

Ky vendim do të vlejë vetëm për këtë rast si rast i veçantë dhe nuk do të vlejë për raste tjera.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**

Nr. 01/011-6141

Më 30 shtator 2009

Prizren



Kryesuesi i Kuvendit  
Nijazi Kryeziu